



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI (SHËRBIME KONSULENCE)

SHQIPËRI
PROJEKTI I BURIMEVE UJORE DHE UJITJES

Titulli i Detyrës

**“Përgatitja e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM)
për Planet e Menaxhimit të Baseneve të lumenjve Drin-Buna dhe Seman”
(Nr. Ref. MEFWA/CS/001a)
(sipas Planit të Prokurimit)**

Identifikimi i Projektit: No.: P121186
Huaja IBRD: No.: 8211 – AL
Granti: No.: TF014255

Kjo Kërkesë për Shprehje Interesi është në vazhdim të njoftimit të përgjithshëm për këtë projekt që është publikuar në *Development Business* online më 25 Maj 2010 dhe njoftimit të përgjithshëm të përditësuar, publikuar më 20 Dhjetor 2012, me numër Reference DB No.WB5260-12/12.

Qeveria e Shqipërisë ka marrë financim nga Banka Botërore në shumën ekuivalente 34.4 milion EUR kundrejt koston së Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes dhe synon të aplikojë pjesë të kësaj shume për Shërbime Konsulente.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) kërkon të angazhojë një kompanie të kualifikuar për të kryer Shërbimet e Konsulencës (“Shërbimet”) **“Përgatitja e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Planet e Menaxhimit të Baseneve të lumenjve Drin-Buna dhe Seman” (Ref. No. MEFWA/CS/001a).**

Qëllimi Kryesor i kësaj Detyre

Planet e Menaxhimit të Baseneve (PMB) të lumenjve Drin-Buna dhe Seman duhet të plotësohen me një Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM) me qëllim përmbushjen e kërkesave të Ligjit Shqiptar Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” dhe të Konventës së Helsinkit dhe Espoo, që Shqipëria ka firmosur dhe ratifikuar dhe që lidhen me menaxhimin e ujrave ndërkufitare. Objektivi i VSM është të sigurojë që çështjet kryesore mjedisore, që lidhen me PMB të lumenjve janë identifikuar dhe vlerësuar, potencialet dhe pengesat kryesore institucionale janë identifikuar dhe janë dhënë rekomandime të qarta për Plane Menaxhimi të Baseneve të Lumenjve sa më të qëndrueshme.

Proçesi i VSM kërkohet, gjithashtu, që të sigurojë dhe t'i kushtojë vëmendje të veçantë takimeve konsultative me grupet kryesore të interesit që iu përkasin baseneve lumore fqinjë si dhe të përfshijë shkëmbimin e informacionit, pikëpamjeve dhe qasjen e mundëshme për të arritur përfitime dhe sinergji shtesë midis baseneve lumore fqinjë, ku është e përshtatëshme.

Detyrat Specifike

Pritet që Konsulenti do të ndërmarrë detyrat, që përbëjnë këtë kontratë brenda kohëzgjatjes së kontratës, siç specifikohet në Termat e Referencës (TeRs) përkatëse, që llogaritet në 3.5 muaj. Pritet, gjithashtu, që Kompania Konsulente të jetë e disponueshme për të filluar punë shpejt pas firmosjes së kontratës dhe të bëjë të gjitha përpjekjet e mundëshme për përfundimin në kohë të shërbimeve.

Fokusi kryesor i Shërbimeve të Konsulencës do të përqëndrohet në dy VSM të veçanta për PMB të lumenjve Drin-Buna dhe Seman. Fushëveprimi i punës së Shërbimeve të Konsulencës do të përbëhet, por jo detyrimisht të limitohet në detyrat në vijim:

Studimi i VSM do të përfshijë:

- (i) *një studim me të dhënat mjedisore bazë;*
- (ii) *një identifikim dhe vlerësim të impakteve mjedisore të mundëshme, kufizimet, risqet dhe mundësitë;*
- (iii) *një analizë e kornizës për Monitorim & Vlerësim, përfshirë treguesit e performancës;*
- (iv) *një vlerësim i kapaciteteve institucionale për të adresuar sfidat mjedisore;*
- (v) *angazhimi i grupeve të interesit; dhe*
- (vi) *konkluzione dhe rekomandime;*

Studimi i VSM do të ofrojë:

- Vlerësimin Mjedisor të PMB të lumenjve Drin-Buna dhe Seman, duke konsideruar risqet kryesore mjedisore (përfshirë ndërkuftarët, kur është e aplikueshme), kufizimet dhe mundësitë lidhur me planet, impaktet kyçe mjedisore të mundëshme të zbatimit të planeve dhe përputhshmërinë me politikat dhe objektivat mjedisore në Shqipëri;
- Rekomandime për finalizimin e formulimit të PMB të lumenjve Drin-Buna dhe Seman, përfshirë treguesit e performancës, për të përmirësuar qëndrueshmërinë mjedisore të këtyre planeve;

Kualifikimet kryesore

Detyrat nën Shërbimet e Konsulencës “Përgatitja e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Planet e Menaxhimit të Baseneve të lumenjve Drin-Buna dhe Seman” do të ndermerren nga një Kompani Konsulente e kualifikuar dhe me experiencë në punë të ngjashme. Meqenëse SEA është një qasje relativisht e re, veçanërisht, kualifikimet dhe eksperiencia në VSM e planeve, politikat dhe programet duhet të specifikohen qartë për çdo ekspert. Kompania Konsulente do të ketë ekspertizë në angazhimin e grupeve të interesit dhe njohuri të të punuarit në gjuhën Angleze dhe Shqip. Përveç kësaj, eksperiencia në sektorin e ujrave, veçanërisht, në zhvillimin e PMB të lumenjve, si edhe punë të ngjashme në rajon ose Shqipëri është e admirueshme. Shkallë e lartë e fleksibilitetit dhe aftësia për të përmbushur afatet strikt do të vlerësohet.

Parashikohet që Kompania Konsulente e propozuar për këto shërbime do të krijojë një ekip kryesor prej 3 (tre) ekspertësh me kualifikimet dhe eksperiencat specifike të kërkuara.

Stafi i propozuar për kryerjen e detyrave të besuara Konsulentit përbëhet nga:

- ✓ Udhëheqësi i Ekipit (UE);
- ✓ 1 (një) Ekspert Mjedisor (Lokal);
- ✓ 1 (një) Ekspert Institucional (Lokal);

Udhëheqësi i Ekipit të Kompanisë Konsulente do të jetë përgjegjës për cilësinë dhe përputhshmërinë e përgjithshme të të gjitha raporteve dhe dokumentave të prodhuar dhe dorëzuar.

Kohëzgjatja

Parashikohet që periudha e zbatimit për Shërbimet e Konsulencës të kërkuara do të jetë 3.5 muaj.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) fton firmat Konsulente të pranueshme (“Konsulentët”) të paraqesin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve. Konsulentët e Interesuar duhet të japin informacion, që demonstroi që ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat përkatëse për të kryer shërbimet (*Dokumente që tregojnë statusin Ligjor të Konsulentit, biznesi kryesor dhe vitet në biznes; Organizimi i Konsulentit: profesional dhe menaxherial dhe kapacitetet e tij; Përshtatshmëria për detyrën: përshkrimi i kontratave të ngjashme, edhe në rajon: të listohen emrat dhe fushëveprimi i projekteve, vlera e kontratës, koha e zbatimit dhe burimi i financimit; Eksperience në kushte të ngjashme, disponueshmëri e aftësive të përshtatëshme përmes stafit, familiaritet me konventat përkatëse (Helsinki dhe Espoo); broshura etj.*)

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e një Joint Venture ose Nën-konsulencë për të shtuar kualifikimet e tyre.

Kriteret e shortlistimit janë:

- ✓ Biznesi kryesor i Konsulentit, organizimi dhe kapacitetet e tij (në rast të JV biznesi kryesor i Kompanisë Drejtuese dhe bashkëpunëtorëve të saj si dhe organizimi dhe kapacitetet e tyre);
- ✓ Përshtatshmëria për detyrën: eksperiencë e gjërë në Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe përvojë e duhur në Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM);
- ✓ Eksperiencë e shëndoshë pune me Qeverisjen Qendrore dhe Lokale dhe Institucionet Shqiptare;
- ✓ Eksperiencë e provuar në vlerësimin e kapaciteteve Institucionale dhe angazhimin e grupeve të interesit;
- ✓ Eksperiencë në projekte të ngjashme në rajon ose në Shqipëri dhe familjaritet me konventat përkatëse (Helsinki dhe Espoo);

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar tërhiqet në paragrafin 1.9 të Udhëzuesit të Bankës Botërore: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nën Huatë IBRD dhe Kreditë IDA dhe Grantet nga Huamarrësit e Bankës Botërore (Udhëzuesit për Konsulentët), Janar 2011, që përcakton politikën e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Një firmë Konsulente do të përzgjidhet në përputhje me procedurat e vendosura në Udhëzuesit e Bankës Botërore: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore (Janar 2011), bazuar në metodën e përzgjedhjes “**Kualifikimet e Konsulentit**” (CQS).

Konsulentët e interesuar mund të marrin informacion të mëtejshëm lidhur me Termat e Referencës në website të MBZHR: www.bujqesia.gov.al ose në adresën e mëposhteme gjatë orarit zyrtar 08:00 am - 16:30 (nga e Hëna deri të Enjte) dhe 08:00 am – 14:00 të Premten (ora Lokale):

Z. Ilirjan Lame

Menaxher Projekti

Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

**Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001
Tiranë, Shqipëri**

Tel: + 355 4 2226243 – 75129; e-mail: ilirjan.lame@bujqesia.gov.al

Shprehjet e Interesit duhet të dorëzohen jo më vonë se data **12 Dhjetor 2017 (e Martë)**: të printuara (personalisht ose me postë) në adresën e mëposhtëme, brenda orarit zyrtar, dhe elektronikisht në adresën e e-mailit më sipër.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (zyra e Protokollit)

**Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001
Tiranë, Shqipëri**

**Në vëmendje të: Znj. Aurora ALIMADHI
Sekretar i Përgjithshëm**